



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

**TË JESH  
GARANTUES**



# PËRMBAJTJA

- Çka do të thotë të jesh garantues dhe cilat janë rreziqet?
- Cilat janë detyrimet e garantuesit sipas kësaj?
- Si bëhet një person garantues?
- Përgjegjësitë e garantuesit.
- Implikimet e të qenit garantues.
- A e njihni personin i cili dëshiron të marrë hua (kredi) më mirë se sa e njuh banka?
- Pse bankat kërkojnë garantues për kredi?
- Kur duhet të biesh dakord për të qenë një garantues?
- Si mund të ndodhë mosshlyerja e kredisë?
- Çfarë dokumentacioni duhet të shikoni para se të nënshkruani një garanci?
- A do të ndikojë të qenit garantues në vlerësimin tim kreditor?

## **Çka do të thotë të jesh garantues dhe cilat janë rreziqet?**

Të qenit garantues për një person tjetër mund të jetë një favor shumë i madh që i bën personit tjetër, pasi nga kjo mund të varet miratimi apo refuzimi i aplikacionit për kredi. Por ka shumë rreziqe të mëdha të përfshira në të qenit një garantues dhe është e rëndësishme, që njerëzit të kuptojnë këto rreziqe dhe të mendojnë se si mund t'i menaxhojnë ato, para se të pranojnë të bëhen garantues. Ky artikull përshkruan karakteristikat kryesore nga të cilat përbëhen garancitë dhe rreziqet që një person bart duke nënshkruar një garanci.

Disa njerëz mendojnë se nënshkrimi i një garancie është vetëm një formalitet - një mënyrë e thjeshtë dhe që nuk mbart rrezik për të ndihmuar një mik apo koleg, duke i dhënë atij/saj një referencë. Por është më shumë se kaq - ju bëheni përgjegjës për borxhin e tyre, nëse ata dështojnë të përmbushin detyrimet e tyre.

**Garantuesi është një person i cili pranon të jetë përgjegjës për pagesën e borxhit të kredisë së një personi tjetër nëse personi tjetër thyen marrëveshjen e kredisë.**

## Cilat janë detyrimet e garantuesit sipas kësaj?

Kjo do të thotë se nëse huamarrësi nuk e bën pagesën e kredisë në kohë ose nuk i përmbahet ndonjërit prej afateve apo kushteve të marrëveshjes së kredisë, që ka nënshkruar me një bankë ose organizatë mikrokredie, ju do të jeni përgjegjës ndaj bankës ose organizatës mikrokreditore për të paguar çdo pagesë, që ende është borxh për shkak të asaj kredie.

## Si bëhet një person garantues?

Një person mund të bëhet garantues kur, së pari i është kërkuar nga dikush që është i interesuar të huazojë para nëse do të jetë i gatshëm ta ndihmojë të marrë një kredi duke u pajtuar që të jetë një garantues për të dhe së dyti, nënshkruajnë një marrëveshje ligjërish të detyrueshme që quhet garanci, me bankën apo organizatën mikrokreditore. Askush nuk mund të bëhet garantues pa dëshirën e tij dhe pa nënshkruar një dokument ligjor. Por njerëzit që e nënshkruajnë një garanci duhet të jenë të sigurt, se garancia që ata nënshkruajnë nuk është e pakufizuar dhe nuk i lejon bankat të japin kredi të njëpasnjëshme (tjera) për të njëjtin huamarrës pa marrë më parë miratimin e garantuesit. Sigurohuni se gjithmonë e dini shumën maksimale që po garantoni.




## Implikimet e të qenit garantues



Të qenit garantues mund të jetë një gjë e dobishme dhe e vlefshme për ta bërë, sidomos për një të afërm ose një mik. Një gjë e tillë do t'i ndihmonte ata të marrin një kredi të cilën institucioni financiar ndryshe nuk do t'ua jepte ndaj në këtë mënyrë do t'i ndihmojë ata të përparojnë. Në Kosovë, ekziston një presion i lartë nga ana e shoqërisë që i shtyn njerëzit t'i ndihmojnë miqtë apo të afërmit dhe për këtë arsye njerëzit mund të mendojnë se po sillen në mënyrë të paarsyeshëm në qoftë se refuzojnë të ofrojnë ndihmë. Personi i cili ju kërkon t'i bëheni garantues por edhe huadhënësi mund t'ju thotë se gjithë çka ju duhet të bëni është vetëm të nënshkruani një copë letër që u mundëson atyre lejimin e kredisë dhe asgjë më shumë. Për fat të keq, në disa raste rezulton që kjo të jetë shumë larg të vërtetës. Ju po merrni mbi vete një detyrim financiar të mundshëm (shlyerjen e kredisë dhe të gjitha përqindjet e interesit) dhe nëse personi, që ka huazuar paratë nuk arrin t'i paguajë këstet e kredisë, kjo do të bëhet një detyrim i vërtet financiar – ju do të duhet të shlyeni (paguani) kredinë.

## **Pse bankat kërkojnë garantues për kredi? Një pyetje që ju duhet t'i bëni vetes është pse bankat ose organizatat mikrokreditore kërkojnë nga huamarrësit që të kenë garantues?**

Huadhënësi mund t'ju japë shumë arsye, por në thelb ka vetëm një arsye kryesore, se pse ata kërkojnë nga huamarrësit të sigurojnë një ose më shumë garantues dhe arsyeja është sepse huadhënësi nuk është i përgatitur për të marrë përsipër vetë rrezikun e huazimit të të hollave këtij personi. Ata duan dikush tjetër (garantues) të marrë përsipër këtë rrezik.



## **A e njihni personin i cili dëshiron të marrë hua (kredi) më mirë se sa e njeh banka?**

Sigurisht e njihni. Banka mund të mos jetë e gatshme të japë hua për personin pa përfshirjen e një garantuesi për shkak se personi është i ri në moshë apo do që të hapë një biznes rishtas dhe nuk ka krijuar ende një histori kreditimi. Por banka mund të mos jetë e gatshme të japë hua pa garantues për arsye të tjera, të tilla si: sepse e dinë se huamarrësi potencial ka dështuar të shlyejë kreditë në të kaluarën. Pra, të dish dhe të kuptosh arsyet, se përse kërkohet garantues është e rëndësishme, pasi kjo gjë do të ketë një ndikim të madh në vendimin tuaj nëse do të pranoni apo jo, të bëheni garantues. është e rëndësishme, pasi kjo gjë do të ketë një ndikim të madh në vendimin tuaj nëse do të pranoni apo jo, të bëheni garantues.



# Kur duhet të biesh dakord për të qenë një garantues?

Kur të jeni duke u menduar të garantoni për kredinë e dikujt tjetër ju duhet të siguroheni që e njihni mirë atë person dhe të siguroheni që personi ka aftësinë financiare dhe karakterin personal për të shlyer (kthyer) kredinë. Ju, gjithashtu duhet të merrni parasysh se cilat mund të jenë detyrimet tuaja financiare potenciale në qoftë se huamarrësi dështon të paguajë. Ju gjithashtu duhet të jeni të sigurt se mund të përmbushni këto detyrime financiare në qoftë se do t'ju duhet, sepse mund të ndodhë që t'ju takojë juve të shlyeni të gjithë borxhin plus interesin dhe taksat në qoftë se huamarrësi nuk arrin ta bëjë këtë.

Njerëzve shpesh u kërkohet të nënshkruajnë garanci për miqtë e tyre për t'i ndihmuar ata të marrin një kredi. Por, duke e bërë këtë mund të vini në rrezik gjendjen tuaj financiare, nëse miku juaj dështon të shlyej kredinë dhe dështimi mund të jetë për shkak të ndonjë arsyeje që është jashtë kontrollit të mikut tuaj si sëmundje ose papunësi. Kjo gjë gjithashtu mund të tendos raportet tuaja miqësore, në qoftë se ju dhe standardi i jetesës së familjes suaj do të dobësohet ndjeshëm për shkak se ju duhet të paguani kredinë e mikut tuaj.

## Si mund të ndodhë mosshlyerja e kredisë?

Mos pagimi i kredisë nuk është gjithmonë çështje karakteri. Një gjë e tillë mund të ndodhë në qoftë se huamarrësi sëmuret, mbetet papunë ose nuk është në gjendje për të bërë pagesat për disa arsye të tjera të paparashikuara. Në shumicën e rasteve, huadhënësve (bankave) nuk ju intereson përse huamarrësi ka dështuar të shlyej borxhin. Ata do të duan të mbrojnë paratë e tyre dhe në këtë mënyrë do të kalojnë detyrimet e kredisë mbi garantuesin. Edhe në rastin e vdekjes së huamarrësit, kredia do të kërkohet të paguhet dhe banka do t'i drejtohet garantuesit.



# Çfarë dokumentacioni duhet të shikoni para se të nënshkruani një garanci?

Shikojini të dyja, si dokumentin e garancisë dhe atë të kredisë të cilin duhet ta nënshkruajë huamarrësi. Kushtet mund të mos jenë gjithmonë të njëjta. Disa shembuj të gjërave që ju duhet t'i shikoni janë:

■ A jeni duke garantuar një shumë fikse apo mundet që banka në të ardhmen t'i japë huamarrësit një kredi të cilën do ta mbulojë po kjo garanci? Në qoftë se, sipas marrëveshjes së garancisë, huamarrësi është në gjendje të marrë fonde të tjera hua, kjo gjë mund të rritë madhësinë e detyrimit potencial, që keni nën garanci pa dijeninë tuaj. Kjo lloj garanci quhet garanci "e pakufizuar" dhe kjo është shumë më e rrezikshme se sa një garanci "e kufizuar" e cila përcakton shumën maksimale të detyrimit tuaj të mundshëm. Pra, sigurohuni që ju të kuptoni qartë se çfarë lloji të garancisë po nënshkruani. Ju duhet t'i shmangeni nënshkrimin të një garancie "të pakufizuar" nëse është e mundur.

■ A i jep dokumenti i garancisë huadhënësit (bankës) kompetencën (të drejtën) për të tërhequr paratë nga depozitat tuaja bankare, pa pasur nevojë për të marrë ndonjë aprovim shtesë nga ju, nëse huamarrësi dështon të bëj pagesat?

■ A është përdorur ndonjë nga pasuritë tuaja, p.sh pronat, si mbulesë për kredinë dhe si e tillë është në dispozicion të bankës që ajo të mund të kërkojë shlyerjen e kredisë me anë të kësaj pasurie?

■ Ju duhet të dini historinë e kredive të huamarrësit në të kaluarën. Nëse banka ose huamarrësi pretendojnë se ky informacion është konfidencial dhe ju nuk mund ta shihni, ju duhet të thoni se nuk mund të nënshkruani një garanci pa e pasur këtë informacion. Është shumë e rrezikshme të nënshkruani një garanci pa këtë informacion.

Në rastin e garantimit të një kredie, rregulloret e BQK-së kërkojnë nga huadhënësi (banka) t'i japë garantuesit një kopje të marrëveshjes së kredisë. Sigurohuni që ju ta merrni atë. Huadhënësi duhet gjithashtu t'ju informojë për çdo ndryshim në kontratën e kredisë. Ka pasur disa ankesa të paraqitura në BQK për shkak se bankat nuk e kanë bërë një gjë të tillë. Pra, bëjani të qartë bankës se kjo është ajo që ju prisni dhe kërkonit prej saj.

Ju duhet të merrni këshilla të ekspertëve për dokumentin e garancisë para se ta nënshkruani atë për t'u siguruar se i kuptoni plotësisht detyrimet e mundshme, që do të merrni përsipër në qoftë se ju e nënshkruani këtë dokument. Është e rëndësishme që ju të mos mbështeteni tërësisht në këshillat e ofruara nga huamarrësi apo nga institucioni kredi dhënës. Interesat e tyre janë e kundërta e tuajave. Ju duhet të merrni këshilla të pavarura mbi detyrimet që do të merrni në qoftë se do të nënshkruani garancinë.

Nëse jeni nën presion për t'i dhënë dikujt një garanci, mos e bëjë atë deri sa ju të keni marrë këshilla të pavarura, të siguroheni se jeni të vetëdijshëm për të gjitha faktet dhe çështjet kryesore përkatëse dhe ndjeheni komod të ofroni garancinë. Nëse ju dorëzoheni si pasojë e presionit dhe e nënshkruani garancinë pa qenë të informuar mirë, ka të ngjarë të pendoheni dhe të vuani pasoja të rënda.

## **Mos nxito të nënshkruash një garanci!**

Sigurohuni që i kuptoni të gjitha faktet e rëndësishme të kredisë dhe garancisë para se ta nënshkruani atë dhe përpara se kredia të jetë lëshuar. Garancia është një dokument ligjor dhe ju nuk mund të ndërroni mendimin tuaj pas një muaji apo me shumë dhe të thoni se doni të tërhiqeni nga garancia. Për t'u tërhequr nga detyrimi ligjor që keni nënshkruar, huamarrësi ose duhet të paguajë kredinë, gjë të cilën mund të mos jetë në gjendje ta bëjë ose ta mbyllë atë me anë të një kredie të re pa garancinë tuaj si mbështetje ,gjë që huadhënësi mund të mos jetë i gatshëm për ta bërëose duhet të ketë miratimin e bankës, gjë të cilën banka ka shumë pak gjasa ta japë. Pra, tregohuni shumë të kujdesshëm para se të nënshkruani. Garancia, mbasi jepet, vazhdon t' ju mbajë të lidhur derisa detyrimet e huamarrësit ndaj bankës të jenë shlyer plotësisht.

**Përfshirja e garantuesit:** në qoftë se huamarrësi i përmbush plotësisht dhe në kohë detyrimet e kredisë, garantuesi do të jetë shumë pak apo aspak i përfshirë në procesin e pagesës së kredisë. Por nëse diçka nuk shkon si duhet dhe pagesat nuk bëhen garantuesi do të kalojë në qendër të procesit të shlyerjes së kredisë dhe do të bëhet përgjegjës për shlyerjen e kredisë.

Si garantues ju nuk keni kontroll të drejtpërdrejtë mbi sjelljen e huamarrësit. Ju mund të kërkoni nga ai një marrëveshje me shkrim me anë të së cilës ai do t'ju mbajë të informuar për pozitën e tij financiare dhe afatet e shlyerjes së kësteve të kredisë - pasi, ju do të jeni përgjegjës për të bërë këto pagesa nëse huamarrësi dështon. Pra, ju duhet të jeni palë shumë e interesuar.

## **A do të ndikojë të qenit garantues në vlerësimin tim kreditor?**

Mund të ndodhë. Në momentin kur jepet një kredi, të gjitha palët e përfshira në kontratën e kredisë, duke përfshirë garantuesit, regjistrohen nga banka që jep kredinë në Regjistrin e Kredive të Kosovës që administrohet nga Banka Qendrore e Kosovës. Çdo problem në Mos nxito të nënshkruash një garanci shlyerjen e kredisë do të mund, pra, të ndikojë në vlerësimin e kredisë së garantuesit, si dhe vlerësimin e kredisë së huamarrësin.

Të qenit garantues mund të ndikojë në aftësinë tuaj për të marrë hua (kredi), pasi banka mund të shikojë obligimet tuaja si pasojë e garancisë që keni nënshkruar, para se të vendosë nëse ju keni aftësi financiare për të paguar një kredi të re.

Garantuesi nuk ka qenë i informuar për ristrukturimin e kredisë. Në shumicën e rasteve kjo ka qenë një ankesë e ligjshme pasi huadhënësi duhet të ketë si detyrim ligjor dhe sigurisht e ka si detyrim moral ta informojë garantuesin për çdo ndryshim të kushteve të kredisë.

Nga llogaria bankare e garantuesit janë tërhequr para ose llogaria është bllokuar sepse huamarrësi nuk ka shlyer pagesat e kredisë. Në shumicën e rasteve, banka ka vepruar duke ushtruar të drejtat e saj ligjore në bazë të garancisë dhe garantuesi duhet të ketë qenë i vetëdijshëm kur e ka nënshkruar garancinë se ky është një nga rreziqet që ka ndërmarrë. Rastet kur huadhënësit kanë qenë në faj ishin kur nuk e kanë informuar garantuesin se janë duke ndërmarrë këtë veprim kundrejt llogarisë së tij bankare;

Statusi i garantuesit brenda Regjistrit të Kredive të BQK-së është ndryshuar. Ky është një rrezik tjetër për të cilin garantuesi duhet të jetë i vetëdijshëm. Vetëm në qoftë se statusi i garantuesit është ndryshuar në bazë të informatave të pasakta, ankesa do të arsyetohet dhe të dhënat në Regjistrin e Kredive të BQK-së duhet të korrigjohen.

**KËSHILLA MË E MIRË  
ËSHTË QË JU TË  
PËRPIQENI T'I  
SHMANGENI TË QENIT  
GARANTUES SEPSE  
ËSHTË NJË GJË QË BART  
RREZIK DHE SHUMICËN E  
RREZIKUT NUK MUND TA  
KONTROLLONI APO TE  
NDIKONI SA DUHET NË TË.**

Nëse ju është kërkuar të jepni një garanci dhe ju mendoni se për arsye personale apo shoqërore nuk mund të thoni jo, ju duhet të siguroheni se jeni plotësisht të informuar mbi rrethanat financiare të huamarrësit në kohën e lejimit të kredisë dhe në vazhdimësi. Duke qenë të informuar gjatë gjithë periudhës së kredisë, ju do të njoftoheni mbi çështjet apo problemet sapo ato të lindin dhe mund të jeni në gjendje të ndihmoni huamarrësin të adresojë problemet e tij financiare para se të ndodhë që të dështojë të shlyej kredinë.



# **BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**



**BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO**

**Adresa: Rr. Garibaldi nr. 33,  
Prishtinë, Kosovë**

**[www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)**

**E-mail: [info@bqk-kos.org](mailto:info@bqk-kos.org)**

**Telefon: +383 38 222 055**

**Fax: +383 38 243 763**